



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 243, Datë 02.12.2021

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “NOA ENERGY TRADE” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1, gërma “d” dhe nenit 13, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 15, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 02.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr.145/1 prot., datë 25.11.2021, nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 220, datë 27.10.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
- ERE me shkresën nr. 6/16 prot., datë 28.10.2021, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët, nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Shoqëria me shkresat nr. 1001/2 prot., datë 19.11.2021 dhe nr. 1001/3 prot., datë 22.11.2021, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të Aneksit A, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”.
- Dokumentacioni i këtij aplikimi është i plotësuar në zbatim të kërkesave të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose

Heqjen e Licencave ne Sektorin e Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim; neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”. **Plotësuar.**
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor; neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”. **Plotësuar.**
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal; neni 9, pika 3, gërma “a”, “b”, “c”, “d”. **Plotësuar.**
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike; neni 9 pika 4.7 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “f”, “g”, “h”. **Plotësuar.**

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

Dokumentacioni Teknik për Aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike neni 9, pika 4.7,

- **gërma “e”**: (Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi) **Plotësuar pjesërisht. Duke qënë se shoqëria është në proces për krijimin e sistemit IT, vlerësojmë që t’i lihet si kusht depozitimi në ERE i Sistemit IT, me fillimin e operimit.**

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi :

1. Të licencojë shoqërinë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Me fillimin e operimit, shoqëria “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k. të depozitojë në ERE Sistemin IT.
3. Drejtoria e Licensimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes ,të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI